



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 shkurt 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3016_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085); Nenin 12, Nenin 14 dhe 17 të Ligjit për Energjinë (Nr. 05/L-081); Nenin 50 të Ligjit për Promovimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258), Nenin 4, Nenin 5, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8, Nenin 11, Nenin 12, Nenin 13, Nenin 16, Nenin 17, Nenin 18, Nenin 19 par. 1 dhe Nenin 20 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë; Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW ZK Bukosh, Komuna e Vushtrrisë, të datës 17.12.2025 të shoqërisë "MDynamic Solutions" L.L.C., me adresë: Rruga "California" nr. 17, Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës, dhe Vendimet, lejet dhe pëlqimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur më 27 shkurt 2026 nxori këtë:

V E N D I M
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. APROVOHET - dhe i lëshohet AUTORIZIMI** shoqërisë "MDynamic Solutions" L.L.C., me Numër Unik Identifikues (NUI) 812239623 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW**, në parcelat kadastrale: 00695-0, 00697-1 dhe 00698-1 ZK Bukosh, sipas Vendimit 08 Nr. 639 të dt. 15.12.2025 për miratimin e plotësimit ndryshimit të Vendimit për leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 533/25 të dt. 26.09.2025, për "Ndërtimin e Parkut Solar" me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW, ZK Bukosh, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë, dhe Pëlqimin Mjedisor Nr. 1889-2/25 dt. 04.06.2025 dhe Vendimin Nr. 1889-3/25 dt. 17.12.2025 për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- II. OBLIGOHET** - shoqëria "MDynamic Solutions" L.L.C., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi, që të dorëzojë garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve, me vlefshmëri që mbulon periudhën dymbëdhjetë (12) mujore sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.
- III.** Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 198,572.00€ (njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit, dhe në rast se nuk dorëzohet garancioni financiar në ZRRE brenda afatit ligjor



sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi, ky Vendim për Autorizim do të ndërpritet dhe njëkohësisht do të shfuqizohet.

- IV. Autorizimi sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, i lëshohet shoqërisë “MDynamic Solutions” L.L.C., sipas Planit Dinamik të Realizimit, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike.
- V. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- VI. Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPHI për projektin Energjetik për Kapacitetet e reja Gjeneruese, do të jetë kusht për fillimin e operimit komercial.
- VII. Shoqëria “MDynamic Solutions” L.L.C., për projektin Energjetik para hyrjes në operim komercial, duhet të pajiset me licencë për prodhim të energjisë elektrike nga ZRRE.

Ar sy e t i m

- ZRRE, më 17.12.2025 nga shoqëria “MDynamic Solutions” L.L.C., ka pranuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW**, sipas VENDIMIT PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E LEJES NDËRTIMORE të Komunës së Vushtrrisë, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 24.12.2025, Njoftimin Publik e ka publikuar edhe në faqen zyrtare të ZRRE-së, në pajtim me Nenin 13 par. 4 të Rregullës në fuqi.
- Shoqëria “MDynamic Solutions” L.L.C., me datë 25.12.2025, ka bërë Njoftimin Publik në media të shkruara elektronike, ku ka njoftuar të gjitha palët e interesit se në pajtim me Nenin 8 të Rregullës së Autorizimit ka aplikuar në ZRRE, pas kompletimit të dokumentacionit për marrje të autorizimit, me të cilën palët e interesuara janë njoftuar se vërejtje te tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda tetë (8) ditësh nga data e publikimit.
- ZRRE, brenda këtij afati dhe deri në shqyrtimin e aplikacionit nga Bordi i ZRRE-në, nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo ankesë. Gjithashtu aplikuesi ka dorëzuar edhe pagesën e taksës së shqyrtimit të aplikacionit me datë 15.01.2026 në ZRRE.
- ZRRE, pas analizimit të dëshmive të sjellura sipas Aplikacionit për Autorizim dhe vlerësimit të tyre nga ana e ZRRE-së, ka konsideruar se aplikuesi “MDynamic Solutions” L.L.C., i ka plotësuar kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ato ligjore për tu trajtuar dhe pajisur me Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW**, në parcelat kadastrale: 00695-0, 00697-1 dhe 00698-1 ZK Bukosh, sipas Vendimit 08 Nr. 639 të dt. 15.12.2025 për miratimin e plotësimit ndryshimit të Vendimit për leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 533/25 të dt. 26.09.2025, për “Ndërtimin e Parkut Solar” me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW, ZK Bukosh, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë, dhe Pëlqimin Mjedisor Nr. 1889-2/25 dt. 04.06.2025 dhe Vendimin Nr. 1889-3/25 dt. 17.12.2025



për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 14188 dt. 23.10.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A., Dëshmi mbi të drejtat pronësore, Deklaratën për shitjen e energjisë, Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, Planin e Biznesit, dhe Planin Dinamik të Realizimit për periudhën dymbëdhjetë (12) muaj.

- Projekti është në përputhshmëri me strategjinë e energjisë dhe dokumentacionet relevante për zhvillimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, dhe dëshmive administrative, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vushtrrisë,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 17 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, “MDynamic Solutions” L.L.C., me adresë: Rruga “Callifornia” nr. 17, Preoce, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës, më 27 shkurt 2026, i lëshon këtë:

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW**, në parcelat kadastrale: 00695-0, 00697-1 dhe 00698-1 ZK Bukosh, sipas Vendimit 08 Nr. 639 të dt. 15.12.2025 për miratimin e plotësim ndryshimit të Vendimit për leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 533/25 të dt. 26.09.2025, për “Ndërtimin e Parkut Solar” me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW, ZK Bukosh, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë, dhe Pëlqimin Mjedisor Nr. 1889-2/25 dt. 04.06.2025 dhe Vendimin Nr. 1889-3/25 dt. 17.12.2025 për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
2. Me këtë Autorizim, autorizohet shoqëria MDynamic Solutions” L.L.C., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara Rregullën e Autorizimit.
3. Ky Autorizim lëshohet sipas Planit Dinamik të Realizimit duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 2.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
 - 2.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundojë sipas Nenit 19 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE.
7. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezullojë këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimit për Ndërtim** të shoqërisë MDynamic Solutions” L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike – ZK Bukosh, me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW**, Komuna e Vushtrrisë, si në vijim:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.1889-2/25 dt. 04.06.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimi nr. 1889-3/25 të dt. 17.12.2025 për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor Nr.1889-2/25 dt. 04.06.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimin 09 nr. 112/2025 të lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: 533/25 të datës 26.09.2025, për “Ndërtimin e Parkut Solar”, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin 08Nr.639 i dt. 15.12.2025 për miratimin e plotësim-ndryshimit të Vendimit për Leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 533/25 të dt. 26.09.2025, për “Ndërtimin e Parkut Solar” me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW, ZK Bukosh të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 14188 dt. 23.10.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.